

KONTRATË - THEMELIMI

E SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"NIKA" SH.P.K.

Personat që firmosin më poshtë:

Z. LLAMBI NIKA, I BIRI I KOÇOS, I DATËLINDJES 1962, LINDUR DHE BANUES NE QYTETIN E SARANDES, LAGJA NR.4, ME SHPETESI SHQIPTARE.

Z. PANDELI NIKA, I BIRI I KOÇOS, I DATËLINDJES 1960, LINDUR DHE BANUES NE SARANDE, LAGJA NR.2, ME SHPETESI SHQIPTARE.

Kanë hartuar më poshtë vijon kontratën e themelimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, të cilën janë marrë vesh ta themelojnë midis tyre.

Shoqëria vepron në bazë të dispozitave ligjore në fuqi si dhe të dispozitave të statutit që i bashkëngjitet këtij akti.

Emërtimi i shoqërisë është "NIKA" SH. P. K.

Objekti i shoqërisë është:

USHTRIM TE AKTIVITETIT PRIVAT NE TREGTIMIN ME SHUMIC DHE PAKIC TE ARTIKUJVE INDUSTRIAL, BUJQESOR, BIEKTORAL, USHAKTOR, MATERJALE MBERTIMI, HIDRAULIK, HIDROSANITARE, ELEKTRIKE, PJESE KEMERINI TE LLOJVEVE TE NDRYSHME, IMPORT-EKSPORT TE TE GJITHE ARTIKUJVE.

Selia e shoqërisë gjendet në lagjen nr.3 në qytetin e Sarandes, por me kalimin e kohës selia e shoqërisë mund të ndryshojë si brenda ashtu edhe jashtë rrethit në pelqimin e ortakëve.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë. Ky kapital përbehe nga kontributet e mëposhtme:

Z. LLAMBI NIKA KONTRIBON ME SHUMEN PREJ 50.000 LEKE.

Z. PANDELI NIKA KONTRIBON ME SHUMEN PREJ 50.000 LEKE.

Kapitali themeltar është i ndarë në 100 pjesë, plotësishtë të shlyeshme me vlerë 1000 lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 deri në numrin e serisë 100.



Në bazë të kontributeve të mësipërme:

Z. LLAMBI NIKA , merr 50 pjesë të kapitalit themeltar të renditura sipas numrit të serisë nga 1 deri në numrin e serisë 50, për kontributin e tij në para;

Z. PANDELI NIKA , merr 50 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura sipas numrit të serisë nga 51 deri në numrin e serisë 100 për kontributin e tij në para;

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar, shlyer plotësisht dhe janë shpërndarë ndërmjet ortakëve si më lartë.

Shuma e mësipërme është mbledhur nga Z. LLAMBI NIKA dhe është depozituar në Degën e Bankës së shtetit Sarandë, në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm. Administrator i parë i emëruar është z. LLAMBI NIKA , me një mandat 2-vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje.

Z. LLAMBI NIKA i jepen të gjitha kompetencat të cilat ai i përdor për të kryer të gjitha veprimet e themelimit të parashikuara nga legjislati në fuqi.

Administratori është i ngarkuar të kryejë akte dhe për të marrë angazhime që janë në përputhje me objektin e shoqërisë dhe kompetencat e tij. Pasi të behet regjistrimi i shoqërisë këto akte i nënshtrohen miratimit të bashkësisë së ortakëve jo më vonë se nga data e mbledhjes së Asamblesë që shqyrton dhe vendos për llogaritë e vitit të parë financiar. Ky miratim bën automatikisht kalimin e këtyre akteve dhe angazhimeve në ngarkim të shoqërisë.

Kjo kontratë përpilohet në katër ekzemplarë, në Sarandë, me datën 25/1/1999 në gjuhën shqipe duke pasur të gjitha fuqi të barabartë ligjore. Një kopje dorëzohet në Gjykatën e rrethit Tiranë ku behet edhe regjistrimi i shoqërisë, kopja tjetër lihet në zyrën noteriale, kopja e tretë dorëzohet në degën e tatime-taksave dhe kopja e katërt mbahet nga vetë ortakët e shoqërisë.

O R T A K Ë T

LLAMBI NIKA



PANDELI NIKA

